



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

REPUBLIC OF KOSOVO		KOMUNA E KLINËS	
MUNICIPALITY OF KLINA			
Data e dorëzimit të raportit: 23, 09, 2022			
Org.	Ad.	Thema e Raportit	Shënimet
05-052-33233/22			

**Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve
buxhetore për projekt buxhetin e komunës së Klinës për
vitin 2023**

Shtator, 2022

Hyrje

Deklarata e misionit: Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit Komunal, në sferën e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale (përgatitja e Rregulloreve, Vendimeve, Udhëzimeve etj) që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më të mirë të gjitha Drejtorive të KK. gjithnjë në shërbim të qytetarëve të Komunës.

Deklarata e vizionit: Është përgjegjëse për sigurimin e personelit të drejtorive me udhëzime, politika dhe procedura për menaxhimin dhe implementimin e aktiviteteve, menaxhimin e buxhetit dhe të financave të drejtorive.

Deklarata e Qëllimit: Bashkëpunimi në mes të Komisioneve të KK –së, me subjektet relevante në nivelin qendror dhe lokal, OJQ-të, biznesin etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarit dhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e Komunës sonë.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

Drejtori: Ajet Sejdiu

Deklarata e misionit: Bënë menaxhimin e buxhetit dhe financave të komunës, I siguron drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon liderët komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e komunës.

Deklarata e vizionit: Përgatitja e materialeve për KPF, menaxhimin e financave komunale, përgatitjen e prezantimit të buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat.

Deklarata e Qëllimit: Menaxhimi me efikasitet të buxhetit komunal . përgatit buxhetin komunal për të gjitha Organizatat buxhetore brenda afateve kohore të përcaktuara nga MEF-i, rishikimet buxhetore, analizat, raportet etj.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2023

Kryetari i Komunës së Klinës në bashkëpunim me drejtorinë e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, duke respektuar udhëzimin administrativ NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, ka filluar procedurën me themelimin e Grupit Punues me gjithsej pesë anëtarëve si dhe caktimin e zyrtarit përgjegjës për Koordinimin e Konsultimeve Publike.

Grupi punues ka hartuar planin e brendshëm të organizimit të dëgjimeve buxhetore, ku janë specifikuar të mbahen 4 (katër) dëgjime buxhetore në 4 (katër) lokalitete (Budisalc, Jagodë, Zajm dhe Shtupel). Grupi punues ka vendosur që takimet e tilla të organizohen jashtë orarit të punës, në një orar më të përshtatshme me qëllim që qytetarët të ju përgjigjen thirrjeve për këto organizime. Po ashtu, grupi punues në njoftimet për organizimin e dëgjimeve buxhetore, ju ka mundësuar qytetarëve të kenë mundësi të dërgojnë kërkesat edhe sugjerimet e tyre për projeksione buxhetore në një email adresën zyrtare: vlora.tafili@rks-gov.net.

Metodat e konsultimit	Data Kohëzgjatja	Numri pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takime i drejtpërdrejtë në lokalitetet Budisalc, Rudicë, Stupë dhe Krushevë e Madhe .	30.08.2022, 1 orë.	11 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtrur kërkesa
2. Takim i drejtpërdrejtë me lokalitetet: Jagodë, Videjë	30.08.2022, 37 minuta.	3 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar

dhe Deiq.			kërkesa
3. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Zajm.	30.08.2022, 40 minuta.	6 pjesëmarrës.	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa
4. Takim i drejtpërdrejtë me lokalitetet: Shtupel, Kërrnicë, Grabc dhe Binxhë.	31.08.2022, 48 minuta.	17 pjesëmarrës.	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
5. Publikimi në ueb faqe / platforma elektronike	8 ditë	2 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesë për projeksionet buxhetore

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt buxheti i vitit 2023, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet të procedohet për në kuvendin e Komunës së Klinës si dhe publikohet në Web Faqen Zyrtare të Komunës së Klinës.

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerime për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
Projekt buxheti i vitit 2023	Kërkesë për ndërtimin e urës në fshatin Budisalc, kanal in e ujitjes dhe ujësjellësin.	Kryetari i fshatit Budisalc, Mark Gojani, kërko i ndërtimin e urës se fshatit dhe ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Budisalc, si dhe ndërtimi i pendës në fshatin Stupë, ujësjellësi në këto lokalitete, mirëmbajtje e rrugëve-pastrimi dhe rregullimi i rrugëve fushore.	Pjesërisht pranohet.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, përkatësisht realizimin e projektit të shtrimit rrjetit të kanalizimit në fshatin Budisalc, derisa shtrimi i rrugës me kubëza refuzohet për shkak të pa mundësisë aktuale buxhetore që ka komuna si dhe qasjes të komunës që projekt buxheti i vitit 2023 të jetë sa më gjithëpërfshirës.
Projekt	Kërkesë për	Izet	Pjesërisht	Përgjigja:

buxheti i vitit 2023	ndërtimin e sistemit të ujësjellësit, ndërtimi i urës mbi lumin Drini i Bardh dhe kanali i ujitjes.	Ahmetgjekaj, përfaqësues i fshatit Rudicë, uji i pijes për afro 100 shtëpi, ura në lumin Drini i Bardhë, ndriçimi publik dhe asfaltimi i rrugicave nëpër fshat dhe në mundësi financiare nga institucioni të ndërtohet edhe kanali i ujitjes.	pranohet.	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, përkatësisht realizimin e projektit për shtrim të rrjetit të ujësjellësit në bashkëpunim me “Hidrodrinin” si dhe funksionalizimi i ndriçimit publik në një pjesë të fshatit hyn në kuadër të projektit “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik”, nderisa ndërtimi i kanalit të ujitjes refuzohet për shkak të pamundësisë aktuale buxhetore që ka komuna. Sa i përket asfaltimit të rrugicave në fshatin Rudicë janë proces të implementimit.
Projekt buxheti i vitit 2023	Kërkesë për ndërtimin e kanalit të ujitjes në fshatin Rudicë.	Skender Bajraktari, nga fshati Rudicë, kërkesë për kanal për ujitje.	Nuk pranohet.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale refuzon këtë kërkesë për shkak të pamundësisë aktuale buxhetore që ka komuna.
Projekt buxheti i vitit 2023	Kërkesë për ndërtimin e kanalit të ujitjes për 300 h, ujin e pijes dhe riparimin e rrjetit të ndriçimit publik.	Halil Ahmetgjekaj, theksoi problemet me ndriçim publik, kërkoi riparimin e këtij rrjeti dhe 300	Pjesërisht pranohet.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, ka inkorporuar kërkesën për rregullimin e problemeve me ndriçim publik si dhe riparimin e këtij rrjeti, ndërsa ndërtimi i kanalit për ujitje refuzohet për shkak të pamundësisë aktuale buxhetore që ka komuna.

		hektarë kërkesë për ujitje për 300 hektarë.		
Projekt buxheti i vitit 2023	1.Kërkesë për ndërtimin e kanalit të ujitjes që përfshin një pjesë të fshatit Videjë, trotuarë dhe rrjetin e kanalizimit për fshat. 2. Kërkesë për ndërtimin e urës për këmbësorë tek shkolla teknike që lidh fshatin Deqi me qytetin si dhe funksionalizimin e ndriçimit në fshatin Deiq dhe gjithashtu balancimin e nxënësve nëpër klasë, për shkak numrit të madh të nxënësve në një klasë të vetme, në shkollën e mesme të ultë në Klinë “Motrat Qiriazit” dhe “Ismet Raci”.	1. Gjergj Marku, nga fshati Videjë. 2.Ardian Çuni, nga fshati Deiq.	Pranohet.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, rrjetin e kanalizimit dhe trotuarin për fshatin Videjë, inkorporohen në projektin “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore Videjë-Polce-Paskalicë dhe Krushevë e Madhe”. Projekt ky që do të fillojë të implementimet gjatë këtij muaji, në vlerë prej 105 mijë€, ku do të ketë shtrirje të rrjetit të kanalizimit afro 6 km. 1. Kërkesë për ndërtimin e kanalit të ujitjes që përfshin një pjesë të fshatit Videjë, pritet të jetë prioritet i vitit 2024. 2. Kërkesa për ndërtimin e urës për këmbësorë tek shkolla teknike që lidh fshatin Deqi me qytetin do të inkorporohet në projektin “Ndërtimi i rrugëve (trotuareve) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajm-Deiq. 2. Kërkesa për funksionalizimin e ndriçimit publik në një pjesë në fshatin Deiq, është marr parasysh menjëherë nga drejtoria e Shërbimeve Publike, ku është bërë vendosja e njehsorit dhe funksionalizimin e ndriçimit publik të asaj pjese. 2. Sa i përket balancimit të numrit të nxënësve në shkolla, ka filluar tashmë me nxënësit e klasës së parë, ndërsa do të vazhdohet në të gjitha klasat në shkollat e tjera sipas udhëzimit

				administrativ: <u>UDHËZIM ADMINISTRATIV</u> <u>NR.22/2013 NUMRI MAKSIMAL I</u> <u>NXËNËSVE PËR KLASË DHE</u> <u>RAPORTI MËSIMDHËNËS-NXËNËS,</u> i cili parasheh lejimin deri në 35 nxënës në klasë.
Projekt buxheti i vitit 2023	1. Kërkesë për ndërtimin e kanalizimit për trajtim të ujërave të zeza apo në fshatin Zajm, në rrugën “Rruga e Tregut”, mbi 500 metra kanalizim.	1. Zenel Zogaj, nga fshati Zajm	Pranohet.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar, në projektin “Ndërtimi i rrugëve (trotuare) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajm- Deiq”.

Projekt buxheti i vitit 2023	1. Kërkesë për asfaltimin e rrugicës, pjesë e rrugës “Nazmi Zhabota”. 2. Kërkesë për instalimin e sistemit të ujësjellësit në lagjen “Doqi”. 3. Kërkesë për ndërtimin e kanalizimit për trajtimin e ujërave të zeza. 4. Kërkesë për asfaltimin e rrugicave në lagjen Kerellaj.	1. Arsim Dallaveraj, nga fshati Shtupel. 2. Mujë Doqi, nga fshati Grabc. 3. Ilir Dallaveraj, nga fshati Shtupel. 4. Halil Kerellaj, nga fshati Shtupel.	Pranohet.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, ka potencuar se këto kërkesa të banorëve do të kryhen brenda viti 2021 pasi që janë në procedura të tenderimit publik: 1. https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2022/09/B05-Njoftim-per-Kontrat-Asfalltim-i-rrugve-lokale-Shtupel-Kernnice-1.pdf. 2. https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2022/09/B05-Njoftim-per-Kontrat-Ndertimi-i-kanalizimit-kernnice-Shtupel-Binxhe.pdf. Ndërsa, kërkesa për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit në lagjen “Doqi”, do të realizohet në bashkëfinancim me “Hidrodrinin”.
Projekt buxheti i vitit 2023	1. Kërkesë për rritjen e numrit të bursave komunale. Unë si qytetar i Klinës dhe student në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe propozoj që në draft-buxhetin e ri të ndahen rreth 60-70 bursa e jo vetëm	1. Melos Krasniqi nga Komuna e Klinës.	Pjesë e draft buxhetit.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar, sepse ky draft-buxhet ka paraparë rritjen e numrit të bursave në gjithsej 50 bursa, apo 10 më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Shuma e subvencioneve në drejtorinë e Arsimit është rritur në 36.000€.

	40 sepse numri i vogël i bursave po na diskriminon disa studentë edhe pse me nota me të mira ndaj atyre ne drejtime deficitare dhe nëse rritet numri atëherë edhe përfshirja e të gjithëve do të ishte më e drejtë.			
--	---	--	--	--

Klinë, 20.09.2022

Kryesuesi i Grupit Punues

